



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:223418

Datë: 09.06.2022

Numri i dokumentit: 03115905

K.nr.994/21

GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN, përmes gjyqtarit Menderes Behluli dhe zyrtares ligjore Erzë Mustafa, duke vendosur në lëndën për kundërvajtje ndaj të pandehurit Sh. L nga Gjilani, për shkak të veprës kundërvajtëse –sulm verbal të parashikuar dhe të ndëshkuar nga **neni 4 paragrafi 3** të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike Nr.03/L-124, sipas kërkesës së Stacionit Policor, Qendra në Gjilan **nr.2021-CA-...** të dt.**19.09.2021**, e në bazë të nenit 73, 195, 124 dhe 48 par.2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet më datë **09.06.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Sh. L, nga babai I...i lindur më ..., me vendbanim në Gjilan, rr.”...” nr.4, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse më datë **19.09.2021** në orën **17:25**, derisa ishte duke u zhvilluar ndeshja në Stadiumin e Qytetit në Gjilan, ndërmjet SC Gjilanit dhe KF Ulpianës, në momentin që shënojnë ekipi zyrtar Ulpiana golin e dytë, futet në fushë dyshohet që me një shufër metalike i dyshuari Shkëlqim Limani në tentim për ta goditur referin e ndeshjes L. J por nuk kishte arritur pasi ishte ndalur nga disa futbollist të ekipit vendos dhe pastaj largohet nga fusha nga Njësitët Policore por vlen të ceket se Njësitët Policore të cilët kishin intervenuar nuk kishin siguruar mjetin e fortë për të cilin dyshohet se ishte ekspozuar në rastin e tentimit për ta sulmuar referin.

-me çka ka bërë veprë kundërvajtëse- sulm verbal të parashikuar dhe të ndëshkuar nga neni 4 paragrafi 3 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike Nr. 03/L -124,

Prandaj, në bazë të dispozitës së cekur më lartë shpallet përgjegjës dhe

D Ë N O H E T

ME DËNIM GJOBE në shumë prej **100 (njëqind) €**, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi. Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor ti paguaj kësaj gjykate shumen prej **5 euro** në afat të njejtë si edhe denimin.

Nga një kopje e aktgjykimit t`iu dorzohet palëve në procedurë.

A r s y e t i m

Stacioni Policor në Gjilan, ka parashtruar kërkesën me nr. **2021-CA-...** të dates **19.09.2021**, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartëcekur, për shkak të veprës kundërvajtëse – sulm verbal të parashikuar dhe të ndëshkuar nga neni **4 par.3** Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike Nr.03/L-124 dhe ka kërkuar që të njejtin ta shpall përgjegjës dhe ta denojë sipas ligjit.

Gjyqtari për vërtetimin e gjendjes faktike ftoi me ftesë të pandehurin për datën **24.03.2022**, për të dhënë deklaratë, mirëpo i njejtë edhe pse ftesën me rregull e ka pranuar, mosardhjen nuk e ka arsyetuar dhe për të njejtin gjyqtari vendosi në mungesë konform nenit **48 p.2**, pasi që vepra kundërvajtëse bindshëm vërtetohet nga shkresat e lëndës, procesverbalin e vendit të ngjarjes dhe nuk pati nevojë për prova shtesë dhe vendosi në mungesë.

Gjykata me kujdes shtjelloi provat materiale dhe arriti në përfundim se i pandehuri i lartëcekur, e ka kryer veprën kundërvajtëse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj edhe gjykata i mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 31 pika 1 dhe të njejtit të pandehur i shqiptojë dënimin me gjobë si në dispozitiv duke menduar se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit që i njejtë në të ardhmen mos të përsërisë kundërvajtje të kësaj natyre.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marr në mbështetje të nenit 109 të ligjit mbi kundërvajtjet.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN
Me date 09.06.2022

Zyrtarja ligjore,
Erzë Mustafa

Gjyqtari,
Menderes Behluli

UDHËZIME MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 ditë nga dita e marjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate – Divizioni për Kundërvajtje.